

20220170117

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

Në bazë të nenit 52 paragrafi (2) të Ligjit për Mësimdhënës dhe Bashkëpunëtorë Profesional në Shkollat Fillore dhe të Mesme („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/19), ministri i arsimit dhe shkencës solli

PROGRAMIN E TRAJNIMEVE PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONAL NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME PËR VITIN 2022

Neni 1

Me këtë program përcaktohen trajnimet për zhvillim profesional të bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2022.

Neni 2

Trajnimet për zhvillim profesional të bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2022 janë nga fushat, nënfushat në vijim dhe temat për trajnim:

I. SHKOLLAT FILLORE

1. Punë me nxënësit
 - 1.1. Orientimi i nxënësve në profesion dhe karrierë
 - Orientimi profesional i nxënësve: forcimi i nxënësve përmes vetënjohurive dhe këshillimi për zhvillim në karrierë.
 2. Punë me mësimdhënësit
 - 2.1 Mbështetja e mësimdhënësve në punën me nxënësit
 - Zhvillimi i aftësive sociale dhe vetëbesimi tek nxënësit, ballafaqimi me sjelljen problematike dhe krijimi i klimës pozitive socio-emocionale në orë.
 3. Punë me prindërit
 - 3.1 Përfshirja e prindërve në jetën dhe punën e shkollës
 - Bashkëpunimi ndërmjet familjes dhe shkollës në parandalimin e dhunës së bashkëmohatarëve, bullizimin kibernetik dhe të ngjashme.
 4. Bashkëpunim me komunitetin
 - 4.1 Bashkëpunim me organizatat dhe institucionet profesionale
 - Arsimi inkluziv në praktikë.
 5. Zhvillimi Profesional dhe bashkëpunimi profesional
 - 5.1 Zhvillimi personal profesional
 - Zhvillimi profesional i bashkëpunëtorëve profesional në shkollat.
 6. Puna analitiko-kërkimore
 - 6.1 Kërkimi i punës edukativo-arsimore
 - Kërkimi aktiv në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimit dhe të mësuarit.
 7. Struktura, organizimi dhe klima e shkollës
 - 7.1 Klima shkollore, mjedis i sigurt dhe pjesëmarrje demokratike.
 - Vlerat demokratike në praktikën e arsimit

II. SHKOLLAT E MESME

1. Punë me nxënësit
 - 1.1 Orientimi i nxënësve në profesion dhe karrierë
 - Orientimi profesional i nxënësve: forcimi i nxënësve përmes vetënjohurive dhe këshillimi për zhvillim në karrierë.
 2. Punë me mësimdhënësit
 - 2.1 Mbështetja e mësimdhënëësve në punën me nxënësit
 - Zhvillimi i aftësive sociale dhe vetëbesimi tek nxënësit, ballafaqimi me sjelljen problematike dhe krijimi i klimës pozitive socio-emocionale në orë.
 3. Punë me prindërit
 - 3.1 Përfshirja e prindërve në jetën dhe punën e shkollës
 - Bashkëpunimi ndërmjet familjes dhe shkollës në parandalimin e dhunës së bashkëmohatarëve, bullizimin kibernetik dhe të ngjashme.
 4. Bashkëpunim me komunitetin
 - 4.1 Bashkëpunim me organizatat dhe institucionet profesionale
 - Arsimi inkluziv në praktikë.
 5. Zhvillimi Profesional dhe bashkëpunimi profesional
 - 5.1 Zhvillimi personal profesional
 - Zhvillimi profesional i bashkëpunëtorëve profesional në shkollat
 6. Puna analitiko-kërkimore
 - 6.1 Kërkimi i punës edukativo-arsimore
 - Kërkimi aktiv në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimit dhe të mësuarit.
 7. Struktura, organizimi dhe klima e shkollës
 - 7.1 Klima shkollore, mjedis i sigurt dhe pjesëmarrje demokratike.
 - Vlerat demokratike në praktikën e arsimit.

Neni 3

Ky program hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Nr.18-797/1
21.1.2022
Shkup

Ministër i arsimit
dhe shkencës,
Doc. d-r **Jeton Shaqiri**, d.v.